



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
QENDRA KOMBËTARE E TRANSFUZIONIT TË GJAKUT
Sektori i Administratës dhe Burimeve Njerëzore

Nr 347 Prot

Datë 14 . 09 2026

Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjaku



RAPORT MONITORIMI PËR PLANIN E INTEGRITETIT

Miratuar

Irena SEFERI

DREJTOR



HYRJE

Lufta kundër korrupsionit në Shqipëri vazhdon të jetë një nga sfidat më të mëdha për shoqërinë dhe qeverinë. Korrupsioni ka ndikim të drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit dhe minon besimin e qytetarëve tek institucionet publike. Lufta kundër korrupsionit në Shqipëri mbetet një nga sfidat kryesore të shoqërisë dhe qeverisë. Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2031 thekson se Shqipëria ka një nivel të moderuar përgatitjeje në luftën kundër korrupsionit. Kjo do të thotë se, ndonëse janë bërë disa përpjekje, ende ka shumë për të bërë për të trajtuar problemet thelbësore që nxisin korrupsionin dhe për të krijuar një ambient më të sigurt dhe më të ndershëm. Në kontekstin e zbatimit të politikave për luftën kundër korrupsionit, është e rëndësishme të theksohet se ministrinë dhe institucionet përkatëse kanë bërë vlerësimet e riskut të integritetit dhe kanë miratuar planet përkatëse të integritetit. Megjithatë, vlerësimi i riskut dhe miratimi i planit janë vetëm një hap i parë, pasi zbatimi efektiv i këtij plani kërkon monitorim të hollësishëm dhe të kujdesshëm. Situata është veçanërisht shqetësuese në sektorët e shëndetësisë dhe pronave, ku rreziqet e korrupsionit janë të larta dhe efektet negative janë më të dukshme. Kjo sjell si pasojë nevojën urgjente për një monitorim të vazhdueshëm të integritetit me qëllim vlerësimin dhe përmirësimin e zbatimit të planeve të miratuara.

Bazuar në këtë metodologji, nëpërmjet vlerësimit të integritetit institucional për Qendren Kombetare të Transfuzionit të Gjakut është analizuar zbatimi i standardeve të integritetit dhe se si ndikojnë ato në funksionimin e përgjithshëm të institucionit. Në këtë vlerësim përfshihen analizimi i dokumentacionit, intervistat me stafin dhe vëzhgimi i praktikave të punës, duke siguruar një pamje më të plotë mbi efikasitetin e masave të marra.

Me anë të monitorimit të integritetit institucional të QKTGJakut synohet të bëhet një vlerësim dhe të përmirësohen standardet e integritetit dhe transparencës brenda institucionit. Përmes analizave të thella, nga vlerësimi identifikohen dobësitë dhe rreziqet potenciale për korrupsion dhe jepen rekomandime për marrjen e masave parandaluese dhe përmirësimin e situatës. Ky vlerësim është i rëndësishëm për të garantuar që praktikën dhe procedurat në QKTGJ të jenë në përputhje me parimet e etikes dhe llogaridhënies. Këto masa janë me rëndësi të madhe që ndihmojnë në krijimin e një kulture etike dhe përgjegjshmërie, që do të kontribuonte në një qeverisje më të mirë dhe më efektive në shërbim të qytetarëve. Në këtë mënyrë, përmirësimi i integritetit institucional është një hap i domosdoshëm drejt krijimit të një ambienti më të sigurt dhe më të drejtë për të gjithë

1. QËLLIMI I RAPORTIT TË MONITORIMIT

Ky raport monitorimi ka si qëllim të vlerësojë ecurinë e zbatimit të Planit të Integritetit (PI) të Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut (QKTGJ) për periudhën Janar 2024- Dhjetor 2025 dhe integritetin institucional të QKTGJ-së, i cili synon të:

- Evidentojë përparimet e bëra:

Analizimi i masave dhe aktiviteteve të zbatuara në përputhje me objektivat dhe afatet e përcaktuara në Planin e Integritetit.

-Identifikojë sfidat dhe pengesat:

Përcaktimi i problemeve dhe vështirësive të hasura gjatë zbatimit të Planit të Integritetit.

-Vlerësojë efektivitetin e masave:

Matja e ndikimit dhe efektivitetit të masave të ndërmarra për përmbushjen e objektivave të integritetit.

-Sigurojë transparencë dhe llogaridhënie:

Informimi i aktorëve kryesorë, përfshirë punonjësit e QKTGJ-së dhe publikun, lidhur me progresin dhe rezultatet e zbatimit të Planit të Integritetit.

-Rekomandojë përmirësime:

Ofrimi i sugjerimeve për përmirësimin e mëtejshëm të procesit të zbatimit të Planit të Integritetit bazuar në të dhënat dhe analizat e kryera.

Monitorimi i zbatimit të masave dhe aktiviteteve të parashikuara në Planin e Integritetit është me rëndësi të madhe për të garantuar integritetin institucional. Me anë të këtij procesi dinamik jo vetëm që vlerësohet niveli i realizimit të masave dhe aktiviteteve të planifikuara, por identifikohen edhe problematikat e hasura gjatë zbatimit si dhe ofrohen rekomandime për përmirësimin e planit të veprimit dhe vetë procesit të monitorimit. Procesi kulmon me hartimin e raportit të monitorimit dhe konsultimin e tij me strukturat përgjegjëse dhe palët e interesuara. Sipas Seksionit 2.2.6 të Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut në Institucionet Qendrore, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë Nr. 334, datë 07.10.20204 , “Zbatimi i Planit të Integritetit do të monitorohet në formë të planifikuar, periodikisht, dhe do të përditësohet në përputhje me zhvillimet apo ndryshimet [e mundshme], që prekin funksionet dhe veprimtarinë e institucionit.” Raportimi është një procedurë e vazhdueshme që siguron ndjekjen dhe zbatimin e planit të veprimit për risqet e integritetit brenda afateve kohore të përcaktuara.

2. METODOLOGJIA E VLERËSIMIT

Ky raportim u mundëson personelit të ndërmarrin masa përmirësuese në kohën e duhur, nëse zbatimi i ndonjë mase ka hasur në sfida apo vonesa. Nga ana tjetër, këto raporte përdoren për të vlerësuar progresin në përmbushjen e objektivave të politikave, qëllimeve specifike dhe masave të planifikuara për realizimin e reformave. Në këtë kuadër, monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të Planit të Integritetit si një etapë e rëndësishme e ciklit të menaxhimit të risqeve të integritetit në institucion, siguron që:

1. Aktivitetet e kontrollit dhe masat e trajtimit të risqeve të integritetit të jenë efektive në hartim, funksionim dhe zbatim;
2. Procedurat të jenë të qarta;
3. plani i integritetit të përçohet në institucion.

3. METODOLOGJIA E MONITORIMIT

Raporti i monitorimit të Planit të Integritetit të Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjaku për periudhën Janar 2024- Dhjetor 2025, në bazë të objektivave dhe afateve të përcaktuara në Planin e Veprimit të Planit të Integritetit, në kuadër të rritjes së integritetit dhe luftës kundër korrupsionit.

Ky raport monitorimi është hartuar mbi bazën e kontributit të dhënë nga strukturat brenda QKTGJ, përgjegjëse për procesin monitorues në kuadër të zbatimit të masave dhe aktiviteteve të Planit të Veprimit të Planit të Integritetit Janar 2024- Dhjetor 2025.

Personat përgjegjës për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, kanë kryer koordinimin me të gjithë sektorët, duke vijuar më pas me hartimin e raportit të monitorimit. Të dhënat e këtij raporti janë dhënë nga përfaqësuesit e sektoreve përkatës, ku përmendim si më poshtë:

- Sektori I Administratës dhe Burimeve Njerëzore
- Sektori I Sigurimit të Cilësisë dhe Hemovigilencës
- Sektori I Financës

Secila strukturë ka raportuar mbi nivelin e zbatimit të çdo objektivi, fushë me risk, masë (mbi bazë aktiviteteve të kryera), hapat e ndërmarrë, dokumentacioni i hartuar apo publikuar, problematikat e hasura, rekomandime etj. Me qëllim monitorimin e zbatimit të angazhimeve të ndërmarra, sa i përket realizimit të masave, procesi i monitorimit është kryer për çdo objektiv dhe fushë me risk të Planit të Integritetit.

Sa më sipër, në kuadër të hartimit të progres raportit për periudhën Janar 2024- Dhjetor 2025 janë analizuar të dhënat si më poshtë:

- Zbatimi i masave (realizimi i produkteve) duke dhënë një rezultat sasior dhe cilësor të realizimit të tyre kundrejt kryerjes së aktiviteteve që lidhen me to.

- Arritja e vlerës së synuar për vitin Janar 2024- Dhjetor 2025 e përcaktuar në treguesit e performancës, duke vlerësuar edhe shkallën e ndikimit të masave të realizuara në arritjen e vlerës së synuar .
- Realizimi i objektivave nëpërmjet llogaritjes së realizimit të masave dhe aktiviteteve.

Zbatueshmëria e masave dhe aktiviteteve të Planit të Veprimit klasifikohet me vlerat si më poshtë:

- **E realizuar:** Sektorët kanë raportuar statusin “E realizuar” për ato masa/aktivitete të cilat janë përmbushur.
- **Pjesërisht :** e realizuar/Në proces: Institucionet kanë raportuar statusin “Në proces” për ato masa/aktivitete, të cilat në periudhën e raportimit kanë pasur zbatim të pjesshëm dhe/apo që vijnë të jenë në zbatueshmëri prej tyre
- **E përcaktuar:** Të pazbatuara janë raportuar ato masa/aktivitete të cilat nuk kanë regjistruar zhvillim për periudhën raportuese si dhe gjithashtu ato masa/aktivitete për të cilat nuk është dhënë raportim nga sektorët përgjegjës.

Analiza e të dhënave dhe vlerësimi i progresit të zbatimit të Planit të veprimit të Planit të Integritetit 2023-2025, të QKTGjakut, për këtë periudhë raportimi është bërë në zbatim të Urdhrit nr. 302, datë 31.10.2023 “Për miratimin e Planit të Integritetit të Qendres Kombëtare të Transfuzionit të Gjaku”

Në referencë dhe zbatim të kësaj metodologjie, QKTGJ ka parashikuar në Planin e Integritetit 2023-2025 të institucionit procedurën që duhet ndjekur lidhur me raportimin mbi zbatimin e Planit të Integritetit, afatet kohore për raportim si dhe strukturën përgjegjëse për monitorimin e ecurisë së zbatimit të Planit të Integritetit duke pasqyruar kryerjen e aktiviteteve nga ana e punonjësve/ grupeve të punonjësve, përgjegjës për zbatimin e masave të miratuara në të. Plani i Integritetit parashikon edhe kryerjen e një vlerësimi mbi efektivitetin e masave të zbatuara për të evidentuar nëse këto masa kanë nxjerrë në pah ndryshime të kontekstit të institucionit apo ndryshime të vetë risqeve, të cilat mund të kërkojnë rishikimin e vetë planit. QKTGJ ka miratuar Planin e Integritetit me Urdhrin Nr.302/3 prot të Drejtorit të QKTGJ, datë 31.10.2023, gjithashtu janë caktuar personat përgjegjës për mbikqyrjen dhe zbatimin e tij me Urdhrin nr.133, datë 02.11.2023.

Plani i Integritetit i Qendres Kombëtare të Transfuzionit të Gjaku, është një instrument i luftës kundër korrupsionit dhe rritjes së integritetit në radhët e punonjësve të saj dhe konceptuar i shtrirë në periudhën 2 vjeçare, konkretisht 2023-2025. Në Planin e Integritetit janë përcaktuar gjithsej 5 objektiva si më poshtë :

- 1 Sistemi I Menaxhimit të Burimeve Njerezore dhe forcimi I kapaciteteve njerezore në lidhje me etiken dhe integritetin.
- 2 Rritja e transparencës në ndarjen e informacioneve publike.

- 3 Permisimi I sistemit te ruajtjes se dokumentacionit dhe I arkives.
- 4 Permisimi I efikasitetit, transparences dhe llogaridhenies ne sektorin mjekesor te QKTGJ.
- 5 Permisimi I sistemit te planifikimit dhe menaxhimit financiar.

Në zbatim të objektivave të Planit të Integritetit në Planin e Veprimit 2023-2025 janë parashikuar gjithsej 16 fusha me risk si më poshtë: 6 (gjashte) fusha me risk per systemin e Menaxhimit te Burimeve Njerezore dhe Forcimi i kapaciteteve njerezore ne lidhje me etiken dhe integritetin.

- 6 (gjashte) fusha me risk per menaxhimin e burimeve njerezore dhe forcimi i kapaciteteve njerezore ne lidhje me etiken dhe integritetin.
- 2 (dy) fusha me risk per Rritjen e transparences ne ndarjen e informacioneve publike.
- 3 (tre) fusha me risk per Permisimin e sistemit te ruajtjes se dokumentacionit dhe I arkives.
- 3 (tre) fusha me risk per Permisimin e efikasitetit, transparences dhe llogaridhenies ne sektorin mjekesor te QKTGJ
- 2 (dy) fusha me risk per Permisimin e sistemit te planifikimit dhe menaxhimit financiar.

Tabela e mëposhtme pasqyron numrin e objektivave, fushave me risk dhe masave sipas Planit të Veprimit të Planit të Integritetit 2023 – 2025.


OBJEKTIVI	FUSHA ME RISK	MASA
Objektivi 1 (një)	6 (gjashte)	9 (Nente)
Objektivi 2 (dy)	2 (dy)	3 (Tre)
Objektivi 3 (tre)	3 (tre)	5 (Pese)
Objektivi 4 (kater)	3 (tre)	4 (Kater)
Objektivi 5 (Pese)	2 (dy)	2 (dy)
Totali	16 (Gjashtembedhjet)	23 (Njezet e tre)

Raporti i monitorimit përmban të dhëna në zbatim të objektivave dhe masave të parashikuara në Planin e Veprimit të Planit të Integritetit të QKTGJakut, për periudhën Janar 2024- Dhjetor

2025, për hapat e ndërmarrë, statusin e zbatimit dhe problematikat e hasura për realizimin e tyre.

Në zbatim të masave dhe aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit Janar 2024- Dhjetor 2025, të Planit të Integritetit, të gjitha strukturat e QKTGJ, gjatë kësaj periudhe kanë përqëndruar punën e tyre në realizimin e objektivave specifike të parashikuara për këtë periudhë raportimi. Përmes zbatimit të Planit të Veprimit Janar 2024- Dhjetor 2025 në zbatim të Planit të Integritetit, gjatë kësaj periudhe raportuese janë realizuar plotësisht 17 masa, pjesërisht 4 masa dhe nuk janë realizuar 2 masa.

Grafiku i mëposhtëm tregon realizueshmërinë e masave dhe aktiviteteve për periudhën Janar 2024- Dhjetor 2025.



Objektivi nr 1 .

Sistemi I Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe forcimi i kapaciteteve njerëzore në lidhje me etikën dhe integritetin.

Për këtë objektiv janë parashikur 6 fusha me risk për të cilat janë marrë 9 masa. Zbatimi i këtyre masave janë si më poshtë :

Është çuar shkresë për plotësim të organikës me specialist IT dhe Inxhinjer Biomjekësor Ministrise se Shendetesise dhe Mireqenies Sociale (MSHMS) shkresa me nr 160 prot datë 27.03.2023 dhe shkresa me nr 126 prot datë 29.02.2024 por nuk ëshë marrë miratim dhe zgjidhje.


Është çuar propozim për ristrukturim të organikës e cilat është miratuar me Urdhër Ministri nr.4748/1 Prot datë 05.12.2024.

Janë zhvilluar takime periodike me personelin e QKTGJ-së për njohjen me rregulloren e Konfliktit të Interesit dhe sigurinë e të Dhënave Personale. Një kopje zyrtare e këtyre rregulloreve është atashuar në dosjen e secilit punonjës.

Pershkrimi I vendeve të punës është rishikuar dhe janë përfshirë detyrat e reja në pershkrimet e punës mbështetur në rregulloren e brendshme të institucionit.

Jane kryer në mënyrë të vazhdueshme trajnime të personelit në bashkëpunim me ASPA dhe Konferenca të ndryshme mjekesore nga QKEV dhe donator të ndryshëm.

Është ngritur komisioni disiplinor për zbatimin e Kodit të Etikës dhe ka filluar punën për rishikimin e Kodit të etikës në zbatim të legjislativës në fuqi.




Objektivi Nr 2. Rritja e transparencës në ndarjen e informacioneve publike.

Për këtë objektivi janë parashikuar 2 fusha me risk për të cilat janë marrë 3 masa. Zbatimi i këtyre masave janë si më poshtë :

Perditesimi i Faqes së WEB dhe i faqes zyrtare qktgj.gov.al dhe mbajtja e rrjeteve sociale janë realizuar dhe vazhdojnë të jenë aktive.

www.qktgj.gov.al dhe <https://qktgj.gov.al/programi-i-transparencës/>

Realizueshmeria e Objektivit nr.2




Objektivi Nr 3 . Permisimi I sistemit te ruajtjes se dokumentacionit dhe I arkives.

Per kete objektiv jane parashikur 3 fusha me risk per te cilat jane mare 5 masa. Zbatimi I ketyre masave jane si me poshte :

Ne bashkepunim me MSHMS eshte duke u ndertuar sistemi I ri I digitalizimit te protokollit dhe po kryen ne menyre te vazhdueshme trajnime per kete system deri ne venien ne funksion te tij. Programi eshte duke u ndertuar nga AKSHI dhe Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave. Gjithashtu eshte ne proces perditesimi paisja e softuerit te arkives digitale.

Eshte vleresuar ngarkesa e punes te kesaj njesie dhe eshte ngritur nje pune me urdher nr.89 date 12.08.2025. Angazhime te tjera te objektivit mbeten ende ne proces.

Realizueshmeria e Objektivit nr.3



Objektivi Nr 4


Permisimi I efikasitetit, transparencës dhe llogaridhenies ne sektorin mjekesor te QKTGJ

Per kete objektivi jane parashikur 4 fusha me risk per te cilat jane mare 4 masa. Zbatimi I ketyre masave jane si me poshte:

Gjatë kësaj periudhe janë hartuar procedura të reja standarde të punës dhe janë rishikuar disa nga procedurat ekzistuese. Puna për përditësimin dhe miratimin e të gjitha procedurave të planifikuara është ende në vazhdim.

Ka filluar hartimi i procedurës standarde për inspektimet dhe auditimet në shërbimin e transfuzionit, bankat e gjakut dhe spitalet publike e jopublike që përdorin gjak dhe komponentë të tij me Urdher Nr 69 date 27.06.2024 “ Per hartimin e plan Kontrollit” .

Kontrollet dhe auditimet janë kryer sipas plan kontrollit të miratuar ne nr 267/1 date 27.06.2024 dhe nëpërmjet grupeve të posaçme të punës. Gjatë tyre janë evidentuar problematikat dhe janë dhënë rekomandimet përkatëse për përmirësimin e veprimtarisë.




Objektivi Nr 5

Permisimi I sistemit te planifikimit dhe menaxhimit financiar.

Per kete objektiv jane parashikur 2 fusha me risk per te cilat jane mare 2 masa. Zbatimi I ketyre masave jane si me poshte:

Ne planifikimin Financiar Institucioni ynë ka përgatitur dhe miratuar projekt buxhetin afat mesëm (2024-2026), i dërguar MSMSH, ku përfshihen shpenzimet operative, pagat, sigurimet, investimet të shoqëruara me relacionet përkatëse. Buxheti vjetor i institucionit akordohet çdo fillim viti nga MSMSH. Në zbatim të legjislacionit në fuqi, Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimet publike” dhe udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik, përgatitet dhe miratohet regjistri i parashikimeve të prokurimeve publike dhe realizimi i tyre. Çdo fillim vit përgatiten urdhrat përkatës për ngritjen dhe funksionimin e komisioneve të vlerësimit të ofertave dhe të njësive të prokurimeve. Përgatitja, miratimi i evidencave të të ardhurave dhe situacioni i shpenzimeve raportohen çdo muaj, pranë degës së Thesarit dhe MSMSH. Çdo fund vit përgatitet dhe mbyllet bilanci vjetor. Është e rëndësishme që, të gjitha nevojat për planifikim dhe rishikim, të identifikohen qartë, të argumentohen dhe të korrigjohen kur është e nevojshme - Në menaxhimin financiar Kuadri ligjor dhe rregullator i legjislacionit financiar dhe praktikave për menaxhimin e financiar të aktiveve është i mirë përcaktuar. Institucioni përgatit, miraton dhe zbaton rregulla për përdorimin e aktiveve si për nxjerrjen jashtë përdorimit ashtu dhe për mbrojtjen e tyre sipas udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” të Ministrisë së Financave. Rritja e kontrollit të brendshëm dhe drejtimi i vazhdueshëm dhe korrekt i proceseve të menaxhimit financiar, por dhe të shpenzimit të shumave të alokuara, përbëjnë masa thelbësore në drejtim të parandalimit dhe uljes së riskut të korrupsionit.



KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Ky raport monitorimi është kryer në përputhje të metodologjise e monitorimit të instrumentit plan integriteti dhe të hartimit të raport monitorimit.

Në përmbysje të këtij raport monitorimi për periudhën 2024-2025 , të gjetjeve që ky dokument na ofron, të të dhënave analitike që sektorët kanë raportuar dhe të analizës së kryer rezulton se:

- QKTGjakut ka vijuar me zbatimin e planit të integritetit.
- Është rishikuar dhe miratuar Kodi I Etikës duke përshtatur ndryshimet e mundshme sipas legjislacionit të fuqi .
- Është ngritur grupi i punës për zbatimin e skemës së hemovigjilencës me Urdhër nr 436 datë 20.10.2025 gjithashtu është miratuar programi vjetor i Kontrollit të Bankave të Gjakut për vitin pasardhës.
- Është garantuar transparencë dhe ofrim i informacioneve mbi aktivitetet e QKTGJ nëpërmjet faqes së internetit www.qktgj.gov.al dhe Programit të Transparencës.

Hapa të tjera

Në vazhdimësi do të ndiqen hapat për raport monitorimin për periudhën pasardhëse mbështetur në Planin e Integritetit dhe Rregjistrin e Riskut për objektivat e mëposhtme:

- Forcimi i sistemit të menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Integriteti Profesional
- Rritja e transparencës dhe Komunikimi me publikun
- Rishikimi i Kodit të Etikës dhe akteve rregullatore
- Përmirësimi i sistemit të ruajtjes së dokumentacionit dhe arkivës
- Përmirësimi i efikasitetit, transparencës dhe llogaridhënjes në sektorin mjekësor të QKTGJ
- Përmirësimi i sistemit të planifikimit, menaxhimit dhe kontrollit financiar